



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:162960

Datë: 10.05.2024

Numri i dokumentit: 05669295

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr..../. .

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të akuzuarve B..... B..... për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së, dhe A.... B..... për shkak të veprës penale blerja pranim ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par 2 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshme PP/II-nr.1510/22 të datës 05.08.2022, pas mbajtës së seancës se shqyrtimit fillestar të hapur për publikun me datë në prezencë të Prokurores së Shtetit Lumturije Hoxha, të akuzuarit B..... B..... dhe A.... B....., me datë mori dhe shpalli publikisht ndërsa me datë përpiloi këtë:

A K G J Y K I M

Të akuzuarit:

B..... B....., i lindur me në P..., ku edhe banon në rr. M..... B..... p.n, i biri i B..... dhe nënës F..... e vajzërisë P..., i nacionalitetit egjiptian, i identifikuar në bazë të nr. personal i pasaportës, shtetas i Republikës së Kosovës.

A.... B....., i lindur me në P....., ku edhe banon në rrugën Xh..... H....., e biri i R..... dhe nënës R..... e vajzërisë Gj....., i nacionalitetit egjiptian, tel., i identifikuar në bazë të numrit. personal të pasaportës, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar me par, mbrohet ne liri.

JANË FAJTORË

Për shkak se i akuzuari B..... B.....:

Me dt. rreth orës ...:.. në rr. “B.... B....” në parkingun e marketit I.... në P..., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë pasurorë për vete, merr pasurinë e të dëmtuarit M..... M....., në atë mënyre që, pasi i dëmtuari vjen me biçikletën e tij të firmës M.-M..... bike-... dhe të njëjtën e lenë në afërsi të hyrjes së marketit (vendin e posaçëm për biçikleta) dhe hynë në market, aty vjen i pandehuri dhe e merr biçikletën e njëjtë dhe largohet nga vendi i ngjarjes,

- me çka ka kryer veprë penale vjedhje nga neni 313 par. 1 të KPRK-së.

Për shkak se i akuzuari A.... B.....:

Me dt. në rr. “Xh.... H...” në P..., blen sendin për të cilën ka mundur ta dijë se është përfituar me kryerjen e veprës penale, në atë mënyre që, pasi që ngjarja rrjedh si në dispozitivin I dhe i pandehuri si në dispozitivin I shkon tek shtëpia e të pandehurit A.. dhe të njëjtit i kërkon që të ja shes biçikletën M.-M..... bike-...-..., ashtu që i pandehuri e blenë këtë biçikletë në shumë prej 20 € edhe pse ka mundur ta dijë se e njëjta është e vjedhur dhe të njëjtën ja shet të dëmtuarit V.... M.... në shumë prej 70€,

- me çka ka kryer veprë penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par. 2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 7, 17, 21, 38, 39, 3, 47, 48 69, 70, 71, 72, 313 par. 1 të KPRK-së, 333 par. 2 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së të akuzuarve ju shqipton:

Të akuzuarit B..... B.....;

DËNIM TË KUSHTËZUAR ME BURG DHE DËNIM ME GJOBË

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin dënim i pandehuri nuk do të ta mbaj në rast se i njëjti në afat prej 2 (dy) viteve e nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Dënim me gjobë në shumë prej 1.200,00 € (njëmijë e dyqind) euro, të cilin dënim obligohet i pandehuri ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do tju shndërrohet në dënim me burg, ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.

Të akuzuarit A.... B.....;

DËNIM ME GJOBË në shumën prej 1.000,00 € (një mijë euro), të cilin dënim obligohet i pandehuri ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin e mbetur me gjobë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burg, ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.

Të pandehurit secili veç e veç obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 40 € (dyzet) euro në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të dëmtuarit M.... (A...) M... me vendbanim në Rr G... G... nr.7 Komuna P..., V... (A...) M... me vendbanim në Rr M.... D..... F... Z.... K.. P...., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullte civile

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm ka ngrit aktakuzë aktakuzës PP/II.nr.1510/22 të datës 05.08.2022, ndaj të akuzuarve B..... B..... për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së dhe A.... B..... për shkak të veprës penale blerja pranim ose fshehja sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par 2 të KPRK-së.

Ne shqyrtimin fillestar të datës gjykata ne pajtim me nenin 241 par. 1 të KPPRK-se e ka udhëzuar të pandehurit për të drejtën e tyre për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaroi për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe provueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Pasi të akuzuarit kanë hequr dorë nga e drejta e leximit të aktakuzës gjykata është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar aktakuzën dhe nuk kanë nevojë për sqarime shtesë. Me pas gjykata i ka njoftuar te akuzuarit për pasojat dhe benefitet e pranimit te fajësisë.

I pandehuri B..... B..... ka deklaruar se e pranoj fajësinë për vepër penale sipas aktakuzës.

I pandehuri A.... B..... ka deklaruar se e pranoj fajësinë për vepër penale sipas aktakuzës.

Në vlerësimin e pranimit te fajësisë nga ana e te pandehurve gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit te Shtetit i cili ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurve, të njëjtit pranimin e fajësisë e kanë bere ne mënyrë vullnetare nga të pandehurit dhe po ashtu gjen mbështetje ne shkresat e lëndës.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se ne seancën e shqyrtimit fillestar nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 248 par. 1 pika 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 te KPPRK-se, si dhe janë janë vërtetuar faktet nga neni 242 par. 6 të KPRK-se, ngase aktakuza mbështet ne këto prova siç janë: Raporti i oficerit K.... K.....#6174 18.07.2022, raporti i policit R.... P..... #7062 18.07.2022, procesverbali mbi marrjen në pyetje i të dëmtuarit M... M.... në st. pol. në P... më dt. 18.07.2022, procesverbali mbi marrjen në pyetje i të dëmtuarit V... M... në st. pol. në P... më dt. 22.07.2022, procesverbali mbi marrjen në pyetje të të dyshuarit B..... B..... në st. pol. në P... më dt. 22.07.2022, procesverbali mbi marrjen në pyetje të të dyshuarit A.... B..... në st. pol. në P... më dt. 22.07.2022, video inxhizimet e kamerave të sigurisë së marketit I... Fotografitë e biçikletës, ndaj ka marr aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve i cili mbështet në provat në baze të cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurve B..... B..... qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni 313 par 1 të KPRK-së dhe A.... B..... nga neni 333 par 2 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurve duke konstatuar se të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së.

Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin B..... B....., gjykata mori pranimin e fajësisë me parë nuk ka qenë i dënuar mirëpo ndaj të njëjtit janë në zhvillim e sipër procedurat penale sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Pejë me numër PP/II.nr.214/23 të datës 27.02.2023, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së, PP/II.nr.2355/21, të datës 22.12.2021, për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 31 dhe 28 të KPRK-së, PP/II.nr.967/22 të datës 26.05.2022, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, PP/II nr. 2355/2021 të datës 22.12.2021 e poashtu ndaj të njëjtit është në zhvillim e sipër procedura penale sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në P..- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.07/23 të datës për veprën e njëjtë penale “vjedhja” nga neni 313 par. 1 të KPRK-së, pa e paragjykuar prezumimin e pafajësisë. Ndërsa si rrethanë rënduese ndaj të pandehurit B..... B..... gjykata ka gjetur shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale, faktin se i njëjti nuk ka shprehur pendesë dhe as kërkim falje për veprën e kryer.

Në raport me të pandehurin A.... B..... si rrethana lehtësuese gjykata mori pranimin e fajësisë. Ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit A.... B..... gjykata ka gjetur shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale, me parë ka qenë i dënuar me aktgjykimet: e gjykatës Themelore në Prizren P.nr..../. të datës (.....) për shkak të veprës penale, lëndimi i lehtë trupor, nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në P....-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2151-1/20, të datës 04.02.2021, është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, me aktgjykimin e gjykatës Themelore në P.... P.nr..../. të datës për shkak të dy veprave penale: të kanosjes nga neni 181 par.1 të KPRK-së si dhe kanosje nga neni 181 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr.898/21 të datës 18.06.2021 për shkak të veprave penale, është dënuar me dënim me burgim të kushtëzuar në kohëzgjatje 14 muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) vitesh, e po ashtu ndaj të njëjtit është në zhvillim e sipër procedura penale sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.07/23 të datës 04.01.2024 për veprën e njëjtë penale “Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale”

nga neni 333 par.1 të KPRK-së, pa e paragjykuar prezumimin e pafajësisë dhe faktin se i nijeti nuk ka shprehur pendesë dhe as kërkim falje për veprën e kryer.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre duke marr parasysh se dënimi i mëparshme ndaj të pandehuri A.... B..... me kushtë nuk ka ndikuar në rehabilitimin e tij, e poashtu ky dënim do ti parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarit secilin veç e veç që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në shumë prej 20,00 € për paushallit gjyqësor dhe në shumë prej 20,00 € për taksen për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

Komfor nenit 462 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarën e udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2022:162960, 10.05.2024**

Bashkëpunëtorja profesionale

Edona Berisha Kastrati

Gjyqtari i vetëm gjykues

Musë Povataj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.